



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

Me nje operator ekonomik

KOMUNA E ISTOGUT-Njësija e Prokurimit, të cilën e përfaqëson menaxherja z-ja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

"ATOM MED", NTSH Komuna e Prishtinës, me NRB 810878928 të cilën e përfaqëson Drejtori z. Bekim Murati (në vazhdim "Kryersi i shërbimeve", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

**"MIRËMBAJTJA E PISISJEVE PER LABORATOR NE QKMF NE ISTOG"
LOT 3**

Nr. i prokurimit	633-19-3202-2-2-1 - Lot 3
Nr. i brendshëm	633 / 019 / 018-R / 2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 "MIRËMBAJTJA E PAISJEVE PËR LABORATOR NE QKMF NE ISTOG" LOT 3

Lënda e kontratës kornizë është të krijojë kushtet duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve si ne vijim:

1.2 "MIRËMBAJTJA E PAISJEVE PER LABORATOR NE QKMF NE ISTOG" LOT 3

1.3 Përdorimi i kesajë kontrate Publike Kornizë obligon vetem Autoritetin Kontraktues ne Istog.

1.4 kjo kontratë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje kur Autoriteti Kontraktues deshiron të kryejë shërbime perkatëse.

1.5 Kryesit të shërbimeve nuk do të lejohet modifikimi – ndryshimi i çmimit për njësi.

- 1.6 Kjo kontrate Kornizë Publike do te ketë validitet (kohëzgjatje) 24. muaj, dhe është efektive nga data e nënshkrimit te njëjtës.
- 1.7 Kontrata hynë në fuqi me datë: **Gusht 2019** dhe perfundon me datë: **Gusht 2021**

Neni 2 Kushtet e dërgesës:

- 2.1 Afati kohor për kryerje te sherbimeve do te jetë 2. ditë, nga dita e dhenjes se urdhereses nga Autoriteti Kontraktues, ndersa afati i fundit kohor i përfundimit te kësajë kontrate është muaj Gusht 2021
- 2.2 Vendi i dorëzimit të sherbimeve do të jenë QENDRA E MJEKSISË FAMILJARE NE ISTOG” – t adekuate te Autoritetit Kontraktues qendra urbane dhe ruget tjera ne teritorin e Komunës së Istogut.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimet njësi te sherbimeve janë te paraqitura ne Ofertën Financijare, Lista e çmimit te paraqitur nga ofruesi I shërbimeve, datë: **06.06.2019 dhe njeherit pjese perberese e kësajë kontrate.**
- 3.2 Vlera e Parashikuar e kontratës per periudhën 24 mujore. është **8,000,00 € dhe me shkronja: Tetëmijëeuro**
- 3.3 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: **(Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon +- 30% e vleres se kontrates)** po qe se per këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues. Ndersa qe se urdherblerjet kalojne sasine totale te kontrates publike kornizë (duke perfshirë + 30%), pa marre parasysht daten origjinale te nenshkrimit, e njëjta shkeputet automatikisht.
- 3.3 Kjo kontratë mund të shkeputet edhe me heret bazuar ne Nenin 56.11 te Udhzuesit Operativ te PP po qe se e njëjta permbushet me çmim.
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

- 4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - Kjo marrëveshje e kontratës;
 - Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - Tenderi i kryesit te sherbimit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
 - Oferta financiare;
 - Plani per menaxhimin e kontratës
- 4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet





- 5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.
- 5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.
- 5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.
- 5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe, në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:

"ATOM MED"NTSH

Emri:	Zize Bujupaj	Emri:	Bekim Murati
Pozita:	Zyrtar Përgjegjes i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.08.2019	Data:	22.08.2019
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulojnë nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
	2.2	<i>Gjuha e përdorur do të jetë: gjuha Shqipe, Serbe.</i>
Çmimi	3.1	<i>Çmimi për shërbimet: e mirëmbajtjes, riparimit, servisimit dhe ndërrimit të pjesëve, përfshin të gjitha shpenzimet e transportit si dhe shpenzimet e personelit</i>
Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve	6	<i>24 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës.</i>
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11.1	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Operatori ekonomik e riparon (servison) pjesën ekzistuese brenda çmimit të ofruar për mirëmbajtje (servisim), ndërsa në rast se ndërrohet pjesa (montohet e re) ajo paguhet sipas çmimit për njësi sipas specifikimit teknik të pjesëve.</i> • <i>OE obligohet të mbajë evidencë për kryerjen e shërbimit duke e nënshkruar nga të dyja palët.</i> • <i>Të gjitha pjesët e ndërruara duhen të jenë të njëjta me pajisjet ekzistuese ose kompatibil me sistemin</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 25 muaj</i>
Parimet e përgjithshme të pagesave	16.	<i>Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas kryerjes së shërbimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se shërbimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë shërbimet të cilat ofrohen gjatë mirëmbajtjes së rregullt të liftave dy herë në muaj dhe në rast defekti Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga operatori ekonomik intervenim duke mos llogaritur çmimin shtesë për shërbime.</i> • <i>Të gjitha pjesët e ndërruara duhen të jenë të njëjta me pajisjet ekzistuese ose kompatible.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 21.1.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	21.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë</i>

KOMUNA E ISTOGUT					
LOTO 3 - MIREMBAJTJA E PAISJEVE MJEKESORE - PAISJEVE PER LABORATOR.					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia përfaqëse	Cmimi për njësi	Cmimi Total
LOTO 3 - MIREMBAJTJA E PAISJEVE MJEKESORE - PAISJEVE PER LABORATOR					
	PJESË REZERVË PËR MIKROSKOP				
1	Llampë 12 V	Copë	4	8	32
2	Okular	Copë	1	2	2
3	Objektivi	Copë	1	2	2
	AUTOANALIZER BIKIMIK SELECTRA PRO XS				0
1	Lampa 12v 20w	Copë	4	180	720
2	Rrip për perzierje	Copë	4	75	300
3	Shiringa 1ml	Copë	4	350	1400
4	Shiringa 0.1ml	Copë	4	350	1400
5	Gjilpera e serumit dhe reagjentit	Copë	4	2.7	10.8
6	MCB Board	Copë	1	1.5	1.5
7	Membrana për pomp uji dhe pomp të mbeturinave	Copë	4	200	800
8	Filter Uji	Copë	8	85	680
9	Pompë uji	Copë	2	10	20
10	Tuba teflori	Copë	2	105	210
	ANALIZER HEMATOLOGJIK: SFRI H18				0
1	WBC Chamber	Copë	1	10	10
2	"O" Ring për Vacuum	Copë	4	120	480
3	Gjilperë	Copë	5	2	10
4	Sistemi i tubave		4	70	280
	ANALIZER HEMATOLOGJIK: MINDRAY BC-2800				0
1	Komora e leximit	Copë	3	2	6
2	Sistemi i tubave	Copë	2	3	6
	FOTOMETER MIKROLAB 300				0
1	Lampa për lexim	Copë	5	1.5	7.5
2	Tubi Perista Itic	Copë	6	1	6
	FOTOMETER HUMALYSER JUNIOR				0
	Lampa për lexim	Copë	4	1	4
	CENTRIFUGA HETICH EBA 8 S				0
1	Motor	Copë	2	2	4
2	Kushinet metali	Copë	6	0.3	1.8
3	Kushinet Gome	copë	6	0.25	1.5
4	Tabela elektrike	copë	2	1	2
5	Tabelë kontrolli	Copë	2	1.1	2.2
6	Kablllo e drejt e brinjezuar	Copë	6	1	6
7	Siguresa Temperature	Copë	10	1.2	12
8	Rezistor Frenues	Copë	10	1.1	11

N.T.S.H.

AtomMed
medical solution
FERIZAJ

CENTRIFUGA HETICH HEMATOKRIT 24 POS					0
1	Motor	Copë	2	1	2
2	Kushinet Metali	Copë	6	0.9	5.4
3	Kushinet Gome	Copë	6	0.9	5.4
4	Tabela elektrike	Copë	2	1	2
5	Tabelë kontrolli	Copë	2	1.2	2.4
6	Kablo e drejt e brinjezuar	Copë	6	1	6
7	Siguresa Temperature	Copë	10	1.2	12
8	Resistor Frenues	Copë	10	1	10
9	Kyqës Ekuilibri	Copë	2	1.1	2.2
10	SHËRBIMET E RIPARIMIT DHE NDËRRIMIT TË PJESËVE REZERVË	Orë Pune	50	30	1500
TOTALI ME TE GIJTHA NGARKESAT - LOTO 3					7975.7

